

Врз основа на член 55 став 1 од Законот за организација и работа на органите на државната управа („Службен весник на Република Македонија“ бр. 58/00, 44/02, 82/08,167/10 и 51/11) и член 22 став 1 од Законот за средното образование („Службен весник на Република Македонија“ бр. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, 67/17 и 64/18), министерот за образование и наука ја донесе наставната програма по наставниот предмет *граѓанско образование* за I (прва) година од средното стручно образование со четиригодишно траење.

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS

BYROJA PËR ZHVILLIMIN E ARSIMIT



ARSIMI QYTETAR

dizajn modular

Për vitin I

Të gjitha profilet arsimore/kualifikimet

Të gjitha drejtimet/sectorët

Shkup, viti 2019

Titulli i programit mësimor	Arsimi qytetar
Lloji i programit mësimor	I obligueshëm
Vlera e kreditore e programit mësimor	3 kredi ECVET ¹ Numri 3 përcakton kreditë të cilat arrihen me pjesëmarrjen në orët e kësaj lënde mësimore në kuadër të Modulit të përgjithshëm arsimor, angazhimin në orë dhe pjesëmarrjen në procesin e nxënies dhe mësimi.
Drejtimi	Të gjitha drejtimet
Sektori	Të gjithë sektorët
Profili arsimor	Të gjitha profilet arsimore
Titulli dhe niveli i kualifikimit	Të gjitha kualifikimet Niveli IV (i katërt)
Viti shkollor	Viti I (i parë)
Numri i orëve në javë/vit për realizimin e programit mësimor	2/ 72
Qëllimet e programit mësimor	Nxënësi/nxënësja: - të jetë i/e aftë të veprojë si qytetar/e përgjegjës dhe të marrë pjesë plotësisht në jetën civile dhe shoqërore, në bazë të njohurive dhe të kuptuarit të koncepteve dhe strukturave shoqërore, ekonomike dhe politike, si dhe në bazë të njohurive për zhvillimin dhe qëndrueshmërisë globale,

¹ Ligji për Kornizën Nacionale të Kualifikimeve.

	<ul style="list-style-type: none"> - të interesohet për ngjarjet politike dhe ekonomiko-shoqërore dhe komunikimin ndërkulturor për tejkalimin e paragjytimeve, të jetë i/e aftë të bëjë kompromise, - t'i respektojë të drejtat e njeriut si bazë e demokracisë që është themeli për qëndrim të përgjegjshëm dhe konstruktiv, - t'i njohë konceptet themelore që kanë të bëjnë me individët, grupet, organizatat e punës, shoqërinë, ekonominë dhe kulturës, - të jetë i/e aftë që aktivisht të bashkëpunojë me të tjerët për interes të përbashkët apo publik, të jetë i përgjegjshëm për mjedisin jetësor, duke përfshirë edhe zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë, - t'i respektojë diversitetet sociale dhe kulturore, barazinë gjinore dhe të kontribuojë në kohezionin social, - të jetë i gatshëm ta respektojë privatësinë e të tjerëve, - të jetë i vetëdijshëm për qëllimet, vlerat dhe politikat e lëvizjeve shoqërore dhe politike, sistemet e qëndrueshme, sidomos ndryshimet klimatike dhe demografike në nivel global dhe shkaktarët e tyre themelorë, - të jetë i vetëdijshëm për mendimin kritik dhe shfrytëzimin e formave tradicionale dhe të reja të mediejeve, - të mendojë në mënyrë kritike dhe të marrë pjesë në aktivitetet e komunitetit për vendimmarrje në të gjitha nivelet. - të përgatitet në mënyrë konstruktive për të marrë pjesë në vendimmarrje demokratike në të gjitha nivelet dhe në aktivitetet civile, - të përpiqet të sigurojë barazi dhe drejtësi sociale, - t'i kuptojë dimensionet multikulturore dhe socio-ekonomike në shoqëritë evropiane dhe mënyrën se si identiteti kulturor ndikon në identitetin evropian, - t'i identifikojë vlerat evropiane të përbashkëta, - ta njohë integrimin evropian dhe të jetë i vetëdijshëm për diversitetet dhe identitetet kulturore në Evropë dhe në botë.
<p>Njësitë modulare të programit mësimor</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. IDENTITETI QYTETAR-PASQYRË PËR VETEN SI QYTETAR 2. LIDHJA QYTETARE 3. QYTETARI NË SHOQËRINË QYTETARE 4. QYTETARI DHE SHTETI 5. QYTETARI DHE BOTA

Kushtet materiale-teknike dhe hapësinore	<p>Për arritjen e rezultateve nga të mësuarit dhe për realizimin e suksesshëm të aktiviteteve të parapara për nxënësit, mësimdhënia realizohet në klasë-kabinet të pajisur me mjete bashkëkohore të dukshme dhe rekomandohet të ketë pamje në klasë, kontakt më të lehtë vizual dhe audio ndërmjet nxënësve dhe mësimdhënësit dhe ndërmjet vetë nxënësve, ndërsa bankat të jenë të renditura në variante të ndryshme, si: të afuara njëra pranë tjetrës apo të bashkuara, respektivisht të grupuara gjatë formës grupore të aktivitetit.</p>
Normativi i kuadrit mësimor	<p>Mësimdhënien në lëndën Arsimi qytetar për vitin I (e parë) arsim i mesëm profesional katërvjeçar e realizon mësimdhënësi me studime të kryera për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Sociologji, VII/1 ose VI A sipas KMK dhe 240 ECTS, dhe me përgatitjen e përvetësuar adekuate pedagogjike-psikologjike dhe metodike në institucion të akredituar të arsimit të lartë, - Histori, VII/1 ose VI A sipas KMK dhe 240 ECTS, dhe me përgatitjen e përvetësuar adekuate pedagogjike-psikologjike dhe metodike në institucion të akredituar të arsimit të lartë, - Filozofi, VII/1 ose VI A sipas KMK dhe 240 ECTS, dhe me përgatitjen e përvetësuar adekuate pedagogjike-psikologjike dhe metodike në institucion të akredituar të arsimit të lartë.

Njësia modulare 1: IDENTITETI QYTETAR–PASQYRË PËR VETEN SI QYTETAR				
Nr. rendor	Rezultatet nga të mësuarit	Përmbajtjet dhe nocionet	Aktivitetet dhe metodat	Kriteret e vlerësimit *
1.	<p>Nxënësi/nxënësja është i/e aftë të:</p> <ul style="list-style-type: none"> – interpretojë nocionin qytetar dhe t'i shpjegojë faktorët që ndikojnë në identitetin qytetar. 	<p>Vetëdija për identitetin qytetar</p> <p>Nocionet: Identiteti qytetar</p>	<p>Teknikat mësimore: Ide të shumta dhe “kalaveshi” për përkufizimin e nocioneve.</p> <p>Teknika mësimore: Barometër për marrjen e qëndrimit rreth faktorëve që ndikojnë në zhvillimin e identitetit personal.</p> <p>Përpilimi i ditarit të të mësuarit për reflektimin e identitetit personal kulturor.</p> <p>Aktivitet individual-harta abstrakte: mbi faktorët e ndryshëm që ndikojnë në identitet.</p>	<p>Nxënësi/nxënësja mund të:</p> <ul style="list-style-type: none"> – identifikojë llojet e ndryshme të identitetit (personal dhe grupor), – definojë nocionet qytetar, identitet dhe identitet qytetar, – përshkruajë faktorët e ndryshëm shoqëror që ndikojnë në zhvillimin e identitetit qytetar dhe sjelljes së individit, – bëjë analizë kritike për ndikimet e ndryshme në formimin e identitetit personal qytetar, – përgatitë lloje të ndryshme të prezantimeve për vetveten si qytetar.
2.	<ul style="list-style-type: none"> – planifikojë zhvillimin personal dhe të kontrollojë suksesin personal lidhur me synimet e vendosura për zhvillim personal. 	<p>Njohja dhe zhvillimi i cilësive dhe shkathtësive personale</p> <p>Nocionet: Cilësitë</p>	<p>Analiza dhe diskutim mbi temën: “Synimet dhe tiparet e mia para dy viteve dhe sot”.</p> <p>Përpilimi i planit personal për zhvillim.</p>	<ul style="list-style-type: none"> – identifikojë anët e tij të dobëta dhe të fuqishme, – marrë informacion kthyes nga të tjerët për sjelljet personale, – identifikojë sfera për përmirësimin

* Janë vendosur standardet/indikatorët për arritjen e rezultateve nga të mësuarit në bazë të të cilave përcaktohen kriteret e vlerësimit.

		Shkathtësitë Zhvillimi personal	Përpilimi i planit për angazhimin shoqëror në shkollë dhe komunitet.	e shkathtësive të caktuara dhe synimeve relevante, – vlerësojë avancimin sa i përket arritjes së synimeve të identifikuara.
3.	– analizojë dhe të përshtatë sjelljen e vet dhe t'i respektojë qëndrimet dhe nevojat e ndryshme tek të tjerët.	Kontrolli i sjelljes Nocionet: Toleranca Kompromisi	Analiza e tekstit me problem (sipas përzgjedhjes së mësimdhënësit) që kërkon bërjen e kompromisit për zgjidhjen ose tejkalimin e problemit. Luajta e roleve (situatë problematike me dallime në qëndrime), diskutim për sjelljen e nxënësve, Rang-lista e karakteristikave prioritare që duhet t'i posedojë qytetari dhe vlerësimi i qëndrimeve personale në bazë të rang-listës së definuar.	– definojë nocionet tolerancë dhe kompromis, – përshkruajë bashkëpunimin ndërmjet njerëzve në realizimin e synimit të përbashkët, – pranojë se në shoqëri ekzistojnë grupe dhe persona që kanë interesa, qëndrime dhe nevoja të ndryshme – pranojë se duhet të bëhet kompromis midis interesave personale dhe interesave të njerëzve tjerë, – rishikojë sjelljen dhe karakteristikat personale dhe të gjejë mënyra për t'i përmirësuar shkathtësitë e tij/saja sociale.
4.	– analizojë dhe vlerësojë rëndësinë e vlerave dhe normave morale në jetën shoqërore dhe personale të qytetarit.	Etika Nocionet: Etika Vlerat Moralit/normat morale	Nxënësit përpilojnë kod etik të sjelljes në shkollë. Krahasimi dhe analiza e rregullave etike në shoqëri të ndryshme. Diskutim mbi moralin dhe etikën	– identifikojë ndikimin e normave dhe vlerave morale në kontekst më të gjerë kohor, – definojë nocionet: etikë, vlera, moral dhe norma morale –përshkruajë shembuj të veprimeve

			e nxënësve në situata të caktuara reale apo fiktive.	etike dhe jo-etike, – propozojë mënyra për sundimin e etikës në shoqëri.
5.	– analizojë se si njohuritë, emocionet dhe vlerat ndikojnë në mënyrën e sjelljes.	Shprehja e emocioneve Nocionet: Emocionet Empatia Ngushëllimi	Luajta e roleve dhe diskutim për reagimet emocionale të nxënësve (empatia kundrejt ngushëllimit). Refleksioni i manifestimit të emocioneve në situata të ndryshme.	– shpjegojë nocionet: emocion, empati, ngushëllim... – prezantojë shembuj për reaksione të ndryshme emocionale: shprehje ndjenjash, empati, – krahasojë reaksionet emocionale në situata të ndryshme, – vlerësojë reaksionet personale në situata të ndryshme.

Njësia modulare 2: LIDHSHMËRIA QYTETARE				
Nr. rendor	Rezultatet nga të mësuarit	Përmbajtjet dhe nocionet	Aktivitetet dhe metodat	Kriteret e vlerësimit*
1.	<p>Nxënësi/nxënësja është i/e aftë të:</p> <ul style="list-style-type: none"> identifikojë llojet e ndryshme të komunikimit dhe ndikimin e tyre në mënyrën bashkëkohore të të jetuarit dhe të mundet t'i përdorë në mënyrë adekuate të kontekstit. 	<p>Komunikimi</p> <p>Nocionet: Komunikimi Komunikimi efektiv</p>	<p>Ide të shumta: në çfarë mënyrash komunikim midis nesh. Në fund nxjerrim përfundim.</p> <p>Aktivitet në çifte: Çfarë më pëlqen e çfarë nuk më pëlqen në komunikim me të tjerët?</p> <p>Diskutim: Si do të ishte sikur të mos kishim internet dhe telefon?</p> <p>Ushtrim: Transmetimi i një porosie përmes formave të ndryshme të komunikimit (me shkrim, me gojë, në mënyrë verbale, jo verbale...).</p>	<p>Nxënësi/nxënësja mund të:</p> <ul style="list-style-type: none"> numërojë kushte dhe mënyra të ndryshme të komunikimit që ndikojnë në komunikimin efektiv, përshkruajë komunikimin si mjet themelor për t'u kuptuar njerëzit midis tyre bëjë plan për komunikim efektiv (verbal, jo-verbal, digjital) që të përfundojë me ndonjë detyrë të ndërlikuar, aftësojë komunikimin varësisht nga konteksti dhe format e arritshme.
2.	<ul style="list-style-type: none"> njohë pikëpamje të ndryshme për qëndrime të rëndësishme shoqërore dhe të respektojë qëndrime të ndryshme nga të tija/sajat. 	<p>Shqyrtimi i pikëpamjeve dhe qëndrimeve të ndryshme</p> <p>Nocionet: Pikëpamjet Qëndrimet</p>	<p>Teknika mësimore: Barometri-marrja e pozicionit për një deklaratë të caktuar midis "pajtohem" dhe "nuk pajtohem" dhe krahasimi i pozicioneve të ndryshme ndërmjet nxënësve.</p>	<ul style="list-style-type: none"> argumentojë qëndrimet e veta nga fusha të ndryshme, diskutojë për pikëpamje të ndryshme për çështje të rëndësishme shoqërore, pranojë se ekzistojnë vlera,

* Janë vendosur standardet/indiktorët për arritjen e rezultateve nga të mësuarit në bazë të të cilave përcaktohen kriteret e vlerësimit.

			Debat mbi temën (sipas përzgjedhjes së nxënësve) për t'i zhvilluar pikëpamjet dhe qëndrimet e ndryshme nga fushat e ndryshme (arsim, ekonomi, bujqësi, ekologji...).	qëndrime dhe mendime të ndryshme, – shpjegojë se si pikëpamjet e botës i përcaktojnë raportet midis njerëzve.
3.	– vlerësojë rëndësinë e përkatësisë ndaj komunitetit dhe përfitimet e komunitetit nga individët në ndërtimin e vlerave të përbashkëta.	Përkatësia në komunitet Nocionet: Komuniteti Përkatësia Patriotizmi Kozmopolitizmi	Aktivitete në grupe: Sa dhe si e vlerësojmë bashkësinë? Simulim: Si sillem ndaj të tjerëve? Diskutim: Çfarë bashkësie u takojmë. Sa e kemi të fuqishme përkatësinë e bashkësive të ndryshme (rangim për secilin në mënyrë individuale). Diskutim: Çfarë duhet/mundem unë të bëjë për bashkësinë time dhe globale dhe çfarë fitoj/humbas me këtë?	– përshkruajë rolet e individëve dhe kontributin e tyre në bashkësi, – shpjegojë rëndësinë e ndjenjës individuale të përkatësisë ndaj bashkësive të ndryshme, – diskutojë ndikimin e të tjerëve në ndërtimin e ndjesisë së përkatësisë ndaj bashkësisë më të gjerë, – promovojë vlerat e përkatësisë ndaj shtetit të vet (patriotizmin) dhe botës (kozopolitizmin).
4.	– lidh humanizmin, të drejtat e njeriut dhe të drejtën ndërkombëtare humanitare me pozicionin e kategorive të	Humanizmi Nocionet: Humanizmi	Përgjigje individuale të pyetjeve anketuese mbi temën si vepron? Aktivitet individual: Unë, ne dhe ndjenjat (Torbë e dekoruar me tri	– numërojë kategoritë e ndjeshme të qytetarëve të cilëve u nevojitet ndihmë humanitare, – identifikojë institucionet që u

	cenueshme të njerëzve dhe zotohet për respektimin e tyre.	E drejta ndërkombëtare humanitare	çështjet më të rëndësishme në situatë të jashtëzakonshme). Aktivitete në grupe: Hulumtim dhe mapim i organizatave humanitare (që veprojnë në Maqedoni, dhe në shtetet tjera). Zhvillimi i idesë së aksionit humanitar në bashkësi (identifikimi i personave të ndjeshëm, nevojat e tyre) dhe ndërmarrja e iniciativës.	ndihmojnë kategorive të ndjeshme, – identifikojë organizatat ndërkombëtare (Kryqi i Kuq, Gjysmëhëna e Kuqe) që veprojnë për qëllime humanitare, – njohë nevojat specifike të kategorive të ndjeshme në shoqëri.
5.	– analizojë mënyrat e funksionit të diversiteteve në shoqëri dhe të shfaqë gatishmëri t'i respektojë të ndryshmit nga vetvetja.	Pranimi dhe respektimi i dallimeve Nocionet: Dallimet Respektimi Pranimi	Aktivitete në grupe: Gjuha dhe bota (të tregojnë se si gjuhët i lidhin shtetet në botë). Aktivitet individual: Prezantoni ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet individëve dhe grupeve në mjedisin tuaj?	– përshkruajë se si identitete të ndryshme funksionojnë në një shoqëri, – ri-shikojë qëndrimet dhe sjelljet personale në situata konkrete, – diskutojë mbi përfitimet dhe sfidat e jetës dhe punës në një shoqëri me diversitete, – demonstrojë se gjithsecili është i rëndësishëm në shoqëri dhe mund t'i pranojë njerëzit që janë të ndryshëm nga ai/ajo.
6.	– njohë përparësitë e shoqërisë multikulturore dhe të vlerësojë cilësinë e mënyrës së integruar të	Multikulturalizmi dhe jetesa e integruar	Teknika mësimore: Bregu i akullt – çfarë kuptojmë me kulturë??	– numërojë karakteristikat themelore të shoqërisë multikulturore, – definojë çfarë është

	të jetuarit.	<p>Nocionet: Multikulturalizmi Integrimi Interkulturalizmi</p>	<p>Aktivitet individual: Cilat elemente cilave nocione u takojnë? (që ndërlidhen me multikulturalizmin, integrimin dhe interkulturalizmin).</p> <p>Diskusim mbi temën: Përfitimet dhe sfidat e të jetuarit në shoqëri multikulturore.</p>	<p>multikulturalizëm dhe integrim, –njohë integrimin si mënyrë/parakusht për shoqëri interkulturore, –diskutojë dhe gjejë zgjidhje për çështje dhe situata të komplikuar në të cilat duhet të respektohen dallimet kulturore.</p>
7.	– analizojë konfliktet në nivel lokal, nacional dhe global dhe të propozojë mënyra të ndryshme për zgjidhjen e tyre.	<p>Ballafaqimi me konfliktet</p> <p>Nocionet: Konfliktet</p>	<p>Teknika: Ide të shumta: Çfarë është konflikti? Aktivitete në çiftet-“Të mendojmë jashtë kutisë”: konflikt konkret (lokal ose global) dhe mënyrat e tejkalimit ose zgjidhjes së të njëjtit. Aktivitete në grupe: Porosi deri te jashtëtokësori “çfarë është dhunë e çfarë jo dhunë?” Luajtja e roleve: Simulim i tejkalimit ose zgjidhjes së konfliktit në mënyrë jo të dhunshme.</p>	<p>– definojnë nocionin konflikt, – identifikojë llojet e konflikteve-shkaqet, pasojat, – mbrojnë zgjidhjen paqësore të konflikteve dhe të propozojë mënyra konstruktive për zgjidhje, ballafaqim dhe tejkalim të konflikteve, – vlerësojë shkaqet e konfliktit në raport me nevojat e ndryshme të palëve të përfshira.</p>

Njësia modulare 3: QYTETARI NË SHOQËRINË QYTETARE				
Nr. rendor	Rezultatet nga të mësuarit	Përmbajtjet dhe nocionet	Aktivitetet dhe metodat	Kriteret e vlerësimit*
1.	<p>Nxënësi/nxënësja është i/e aftë të:</p> <ul style="list-style-type: none"> – njohë rolin e tij/saj si qytetar/e dhe t'i identifikojë mundësitë për përfshirje aktive në jetën shoqërore. 	<p>Roli i qytetarit në shoqëri</p> <p>Nocionet:</p> <p>Qytetar</p> <p>Shoqëri qytetare</p>	<p>Aktivitete në grupe mbi temën: “Karakteristikat e shoqërisë qytetare”.</p> <p>Krahasimi i shoqërisë qytetare me llojet tjera të shoqërisë përmes përpilimit të tabelës – T.</p> <p>Diskutim: Si t'i arrijë shoqëria jonë karakteristikat e shoqërisë qytetare? Çfarë mund të bëjmë ne?</p>	<p>Nxënësi/nxënësja mund të:</p> <ul style="list-style-type: none"> – numërojë karakteristikat e shoqërisë qytetare, – definojë nocionin qytetar dhe shoqëri qytetare, – identifikojë mundësitë për angazhim në shoqëri qytetare, – demonstrojë pjesëmarrje aktive në proceset shoqërore.
2.	<ul style="list-style-type: none"> – identifikojë të drejtat e njeriut, të drejtat dhe liritë qytetare, t'i respektojë në situatat e përditshme dhe është i/e aftë t'i ndërlidhë me përgjegjësitë e duhura. 	<p>Të drejtat dhe përgjegjësitë</p> <p>Nocionet:</p> <p>Të drejtat</p> <p>Liritë</p> <p>Përgjegjësitë</p> <p>Obligimet</p>	<p>Diskutim mbi temën: “Të drejtat dhe liritë, të drejtat sot, e nesër?”</p> <p>Ngritja e “Shtëpisë të së drejtës” (themeli, muret, kulmi) në bazë të zhvillimit të të drejtave të njeriut.</p> <p>Demonstrim i situatave/shembujve nga jeta e përditshme që ndërlidhen me tetë nivelet e Roxher Hart për Shkallën e pjesëmarrjes së</p>	<ul style="list-style-type: none"> – numërojë llojet e të drejtave dhe përgjegjësisë, – përshkruajë zhvillimin e të drejtave të njeriut, – grupojë të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në shoqëritë qytetare, – debatojë për respektimin e të drejtave dhe përgjegjësisë të qytetarëve në mjedisin e vet .

* Janë vendosur standardet/indikatorët për arritjen e rezultateve nga të mësuarit në bazë të të cilave përcaktohen kriteret e vlerësimit.

			fëmijëve.	
3.	– kuptojë rëndësinë e zhvillimit të qëndrueshëm dhe shfrytëzim racional të resurseve të planetit Tokë.	Qytetari dhe zhvillimi i qëndrueshëm Nocionet: Zhvillimi i qëndrueshëm Resurset Riciklimi Energjensët	Përpilimi i planit për shfrytëzim racional të resurseve në shkollë. Diskutim mbi temën: Konsumi i ujit, rrymës, ujitjes, riciklimit dhe shfrytëzimi i materialit të ricikluar. Përpilimi i materialit promovues (pllakat, afishe, video...) për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe prezantimi i të njëjtit në vend të dukshëm.	– numërojë dhe të diskutojë për shembujt pozitivë nga zhvillimi i qëndrueshëm dhe kursimi i resurseve, – përshkruajë rëndësinë e zhvillimit të qëndrueshëm në segmente të ndara të të jetuarit, – përpilojë plan për shfrytëzimin racional të resurseve, – hulumtojë dhe të propozojë modele të zhvillimit të qëndrueshëm që mund të zbatohen.
4.	– njohë nevojën për inovacion dhe sipërmarrësi për të ndjekur dinamikën e zhvillimit të shoqërisë bashkëkohore.	Qytetari si novator dhe sipërmarrës Nocionet: Inovator Sipërmarrës	Aktivitet në grupe: Përpilimi i projektit (Ideja-projekti-realizimi). Ide të shumta: Karakteristikat e inovatorëve dhe sipërmarrësit. Përmbledhja e ngjashmërive dhe dallimeve. Diskutim: Cili është roli i inovacioneve në zhvillimin e shoqërisë.	– shpjegojë nocionet inovator dhe sipërmarrës, –shpjegojë faktorët që i mundësojnë qytetarit të jetë inovator dhe sipërmarrës, – përshkruajë dhe të diskutojë rreth mundësive për shndërrimin e idesë në projekt.
5.	– analizojë nevojat personale, të	Qytetari si konsumator dhe	Analizë (individuale ose ne grup)	– dallojë mënyrat dhe format e

	përcaktoje prioritetet dhe të planifikojë financimin e të njëjtave .	kursimtar Nocionet: Fitimi Kursimi Investimi Konsumatori	të aspekteve pozitive dhe negative të konsumit dhe kursimit . Aktivitet individual: Vlerësim i nevojave personale dhe gjetja e mënyrave për financimin e të njëjtave.	sigurimit të mjeteve (për shembull: fitimi, kursimi, huazimi dhe investimi), – identifikojë situatat si ndryshojnë nevojat financiare të qytetarëve, – shpjegojë rolin e qytetarit si konsumator dhe kursimtar, – bëjë vlerësimin e përfitimeve dhe rreziqeve nga shfrytëzimi i shërbimeve për kursim/huazim në bankë.
6.	– vlerësojë rolin e organizatave civile dhe grupeve të përfaqësimit në shoqërinë qytetare dhe t'i shfrytëzojë përfitimet prej tyre si qytetar.	Organizatave civile dhe grupet e përfaqësimit Nocionet: Organizata civile Grupe të përfaqësimit	Aktivitet në grupe: Nxënësit formojnë “grupin e vet” (real ose fiktiv), bëjnë programin dhe përpiqen ta realizojnë përmes aktiviteteve të ndryshme. Hulumtim (nga burimet elektronike, anketa, grupe të fokusit dhe ngjashëm) për organizatat civile dhe aktivitetet e tyre. “Ide të shumta”: Organizata civile kundrejt grupeve të përfaqësimit (ngjashmëritë dhe dallimet).	– identifikojë organizatat civile dhe grupet e përfaqësimit, – shpjegojë rolin e organizatave civile dhe/ose grupeve të përfaqësimit, – shpjegojë sfidat me të cilat përballen organizatat civile gjatë veprimit të tyre, – analizojë mënyrat dhe format e veprimit të organizatave civile dhe grupeve të përfaqësimit
7.	– njohë rolin e medieve në demokraci si kontrollues i pushtetit dhe si instrument për	Mediat në shoqërinë demokratike	Ushtrim: Transmetimi i lajmit përmes lojës “telefoni i prishur” dhe diskutim mbi mënyrat e	– numërojë dhe shpjegojë karakteristikat e medieve, – vlerësojë respektimin e parimeve

	pjesëmarrje aktive të qytetarëve në proceset demokratike.	Nocionet: Gazetar Redaktor Censurë Autocensurë	kontrollimit të tyre. Analizë e lajmit të transmetuar në media të ndryshme (sa janë respektuar kriteret gazetareske). Diskutim: Si janë mediat kontrollues të pushtetit? Shoqëruar me hulumtim online me shembuj (lajme, kolumna etj.). Diskutim: Si i shfrytëzojnë qytetarët mediumet për të marrë pjesë në proceset demokratike? Shoqëruar me hulumtim online me shembuj. Aktivitet në grupe: Përpilimi i gazetës së shtypur/muri apo e-gazetës. Luajtja e roleve: Gazetar, redaktor, pronar mediumi. Diskutim: Si i shfrytëzojnë qytetarët mediumet për pjesëmarrje në proceset demokratike	për punën e medieve (pavarësia, përgjegjësia, vërtetësia, etika), – analizojë dhe vlerësojë përmbajtjet e ndryshme mediatike, – vlerësojë se si informacionet transmetohen dhe përjetohen në mënyra të ndryshme.
8.	– vlerësojë në mënyrë kritike ndikimin e religjionit në shoqërinë bashkëkohore dhe të sillet me tolerancë ndaj diversiteteve	Religjioni në shoqëri Nocionet: Agnostik/agnosticizëm	Aktivitet në grupe: “Hulumtim mbi religjionet më të përfaqësuara botërore dhe ndikimi i tyre (pozitiv dhe negativ)	– identifikojë nocionet: agnosticizëm, sekte, ateizëm, fundamentalizëm radikal dhe ekstremizëm, – shpjegojë rolin e religjionit dhe

	religjioze.	Sektet Fundamentalizmi/radikal Fundamentalizmi dhe ekstremizmi	në shoqëritë e botës. Aktivitet në çifte, hulumtim i nociioneve: agnosticizmi, sektet, fundamentalizmi radikal dhe ekstremizmi... Hulumtim (anketë) lidhur me qëndrimet e nxënësve/qytetarëve sa i përket religjionit. Zbatimi i anketës përmes online pajisjeve dhe përpunimi i rezultateve. Diskutim mbi rezultatet e fituara.	organizatave fetare në shoqëri, – njohë dhe të diskutojë për format e fundamentalizmit dhe ekstremizmit fetar radikal, –argumentojë për të drejtën e njerëzve në përkatësi të ndryshme (jo) fetare, – hulumtojë dhe prezantojë aktivitetin-veprimtarinë e grupeve/organizatave të ndryshme religjioze.
9.	– identifikojë rolin e kulturës, institucioneve kulturore në formimin dhe zhvillimin e identitetit kulturor.	Kultura, institucionet kulturore dhe identiteti kulturor Nocionet: Institucionet kulturore Identiteti kulturor	Ese dhe debat mbi temën: “Kultura sot”. Me përdorimin e pajisjes online Coggle.it (apo të ngjashme) të përpilohet projekt për identitetin kulturor. Aktivitet individual: Hulumtim se si institucionet kulturore (kinemaja, teatri, muzeu, opera, baleti) ndikojnë në zhvillimin e tyre.	– numërojë vlerat e përgjithshme civilizuese kulturore, – përshkruajë rëndësinë e të drejtave kulturore në zhvillimin e personalitetit, – shpjegojë faktorët në zhvillimin e identitetit kulturor, – analizojë paraqitjet (fenomenet) pozitive dhe negative në kulturë, – hulumtojë dhe t’i prezantojë tiparet dhe karakteristikat e përgjithshme kulturore në grupet e ndryshme kulturore.

Njësia modulare 4: QYTETARI DHE SHTETI				
Nr. rendor	Rezultatet nga të mësuarit	Përmbajtjet dhe nocionet	Aktivitetet dhe metodat	Kriteret e vlerësimit*
1.	<p>Nxënësi/nxënësja është i/e aftë të:</p> <p>– njohë dhe të vlerësojë vlerat demokratike në shoqëri.</p>	<p>Vlerat demokratike</p> <p>Nocionet: Vlerat demokratike</p>	<p>Përpilimi i tabelës – T për karakteristikat e shteteve demokratike dhe jodemokratike. Ese: Vlerat e demokracisë. Debat: Në shtetet demokratike të gjitha kanë të drejta të njëjta, por nuk kanë mundësi të njëjta për t'i realizuar të drejtat.</p>	<p>Nxënësi/nxënësja mund të:</p> <p>– numërojë vlerat e demokracisë, – mbrojë në mënyrë të argumentuar formën demokratike të udhëheqjes, – analizojë institucionet e rendit demokratik politik.</p>
2.	<p>– identifikojë pushtetin që është në funksion të qytetarëve.</p>	<p>Pushteti në funksion të qytetarëve</p> <p>Nocionet: Pushteti Fuqia Llogaridhënia Transparenca Keqpërdorimi i pushtetit</p>	<p>Aktivitet në grupe: Hulumtimi i kushtetutës dhe ligjeve që janë bazë për konstituimin e pushtetit; Prezantim dhe diskutim i strukturuar. Debat: Si duhet pushteti i zgjedhur t'i përfaqësojë interesat e të gjithë qytetarëve. Shfrytëzimi i mjetit online Plickers (apo në mënyrë tjetër) mbi temën: „Pushteti në funksion</p>	<p>– numërojë karakteristikat e pushtetit në funksion të qytetarëve, – përshkruajë kushtetutën dhe ligjet si bazë për konstituimin e pushtetit në shtet, – polemizojë mbi përdorimin ose keqpërdorimin e kompetencave që dalin nga pozicionet e ndryshme të pushtetit, – debatojë në mënyrë të argumentuar se pushteti i zgjedhur duhet t'i</p>

* Janë vendosur standardet/indiktorët për arritjen e rezultateve nga të mësuarit në bazë të të cilave përcaktohen kriteret e vlerësimit.

			të qytetarëve“.	përfaqësojë interesat e të gjithë qytetarëve .
3.	– shpjegojë funksionimin e shtetit dhe t’i identifikojë mënyrat e pjesëmarrjes në pushtet dhe në jetën publike.	<p>Si është organizuar pushteti në Republikën e Maqedonisë së Veriut</p> <p>Nocionet: Pushteti ligjvënës Pushteti ekzekutiv Pushteti gjyqësor Decentralizimi Vetëqeverisja lokale</p>	<p>Ide të shumta rreth ndarjes së pushtetit. Hulumtim dhe prezantim për kompetencat e pushtetit dhe institucionet që i përfaqësojnë. Harta konceptuale e pjesëmarrjes qytetare në pushtet dhe në jetën publike.</p>	<p>– dallojë pushtetin ligjvënës, ekzekutiv, gjyqësor dhe lokal, – numërojë kompetencat e katër tipave të pushtetit, – përshkruajë rëndësinë e decentralizimit të pushtetit, – përshkruajë ndarjen e pushtetit si kusht për kontroll të ndërsjellë dhe kufizim të fuqisë së pushtetit, – prezantojë mënyra konkrete të pjesëmarrjes aktive në pushtet dhe në jetën publike.</p>
4.	– njohë karakteristikat e shtetit juridik dhe t’i shpjegojë fenomenet negative që e prishin sundimin e së drejtës.	<p>Sundimi i së drejtës</p> <p>Nocionet: Shteti juridik Integriteti/presioni social Korrupsioni Nepotizmi</p>	<p>Aktivitete në çifte për definimin e nocioneve: shtet juridik, integritet/presion social, korrupsion dhe nepotizëm përmes hulumtimit. Analizë të rasteve (rrëfimeve) në të cilat janë paraqitur veprime të ndryshme korruptuese dhe diskutim. Debat mbi temën: “Përse sundimi selektiv i drejtësisë është vrasës për demokracinë?”</p>	<p>– përshkruajë karakteristikat e shtetit juridik, – definojë nocionet: integritet/presion social, korrupsion dhe nepotizëm, – përshkruajë format në të cilat mund të paraqitet korrupsioni, – vlerësojë përfitimet për shoqërinë nga parandalimi dhe lufta kundër korrupsionit, – kritikojë dhe të dënojnë sundimin selektiv të drejtësisë.</p>

5.	<p>– njohë mënyrat në të cilat qytetarët marrin pjesë në proceset politike dhe të vlerësojë rëndësinë e zgjedhjeve në zhvillimin e demokracisë.</p>	<p>Zgjedhjet dhe proceset demokratike në shoqëri</p> <p>Nocionet: Fushata zgjedhore Sistemi i shumicës Sistemi proporcional</p>	<p>Diskutim: Në çfarë mënyre qytetarët marrin pjesë në proceset politike (format e pjesëmarrjes). Aktivitet në grupe: Analizë e opinionit publik, fushatat zgjedhore dhe reklamat ndikimi i mas-medieve në zgjedhje. Ese: Partitë politike dhe kandidatët e pavarur duhet të jenë në funksion të interesave të të gjithë qytetarëve.</p>	<p>– numërojë mënyrat ku qytetarët mund të marrin pjesë në proceset politike: votim, fushata, lobim, mitingje, peticione, – përshkruajë llojet e zgjedhjeve dhe modeleve zgjedhore; – paraqesë shembuj konkretë si partitë politike/kandidatët e pavarur duhet të jenë në funksion të interesave të qytetarëve.</p>
6.	<p>– analizojë dhe vlerësojë rolin shoqëror të shtetit dhe administratës shtetërore.</p>	<p>Roli shoqëror i administratës shtetërore dhe publike</p> <p>Nocionet: Administrata shtetërore Administrata publike</p>	<p>Ide të shumta: Administrata. Tabela e DDM (di-dua të di-mësova) në lidhje me administratën shtetërore dhe publike. Luajtja e roleve: Qytetari dhe institucionet. Debat: Si të bëhen më efikase dhe në shërbim të qytetarëve institucionet publike dhe shtetërore.</p>	<p>– dallojë administratën shtetërore dhe publike, – përshkruajë kompetencat e administratës shtetërore dhe publike, – debatojë për përgjegjësinë e nëpunësve shtetërorë dhe publikë në mbrojtje të të drejtave të qytetarëve, – identifikojë keqpërdorim të kompetencave të administratës shtetërore dhe publike.</p>

Njësia modulare 5: QYTETARI DHE BOTA				
Nr. rendor	Rezultatet nga të mësuarit	Përmbajtjet dhe nocionet	Aktivitetet dhe metodat	Kriteret e vlerësimit*
1.	<p>Nxënësi/nxënësja është i/e aftë të:</p> <ul style="list-style-type: none"> – analizojë dhe të ndjekë ndryshimet në shoqëri si rezultat i rritjes së shkëmbimit kulturor. 	<p>Globalizmi dhe shoqëria</p> <p>Nocionet: Globalizmi Shkëmbimi kulturor</p>	<p>Shfrytëzimi i pajisjes online Plickers (ose në mënyrë tjetër) mbi temën: Globalizimi.</p> <p>Aktivitet në çifte rreth pyetjes hulumtuese-debat: Si reflektohet globalizimi në jetën e përditshme?</p> <p>Aktivitet në grupe:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përfitimet nga globalizimi dhe shkëmbimi kulturor - Sfidat e globalizimit. 	<p>Nxënësi/nxënësja mund të:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Numërojë proceset në të cilat paraqitet globalizimi, – definojë nocionin globalizim, – veçojë përfitimet dhe pasojat nga globalizimi dhe shkëmbimi kulturor, – identifikojë sferat e ndryshuara të globalizimit.
2.	<ul style="list-style-type: none"> – identifikojë pozitën dhe të njohë përfitimet e Republikës së Maqedonisë së Veriut në organizatat ndërkombëtare. 	<p>Republika e Maqedonisë së Veriut në organizatat ndërkombëtare</p> <p>Nocionet: Organizatave ndërkombëtare</p>	<p>Ide të shumta: Në cilat organizata është anëtare Republika e Maqedonisë së Veriut?</p> <p>Metoda Web quest: Në cilat projekte dhe aktivitete ndërkombëtare mund të përfshihen mësimmshënësit dhe nxënësit e shkollës sonë? Si dhe ku të aplikojmë?</p>	<ul style="list-style-type: none"> – numërojë organizatat ndërkombëtare në të cilat Republika e Maqedonisë së Veriut është anëtare, – përshkruajë rolin konkret të organizatave ndërkombëtare në mbrojtje të të drejtave të njeriut dhe në zgjidhjen e problemeve globale të shoqërisë,

* Janë vendosur standardet/indiktorët për arritjen e rezultateve nga të mësuarit në bazë të të cilave përcaktohen kriteret e vlerësimit.

			<p>Aktivitet në grupe dhe diskutim: Përfitimet e Republikës së Maqedonisë së Veriut nga organizatat e ndryshme ndërkombëtare.</p>	<ul style="list-style-type: none"> – shpjegojë procedurat për pjesëmarrje në projekte konkrete (për shembull: mbrojtja e të drejtave të njeriut, mjedisi jetësor etj.), – identifikojë mekanizmat për sigurimin e mbështetjes së Republikës së Maqedonisë së Veriut nga organizatat ndërkombëtare.
3.	<p>– analizojë pozitën e Republikës së Maqedonisë së Veriut sa i përket Bashkimit Evropian (BE) dhe të gjejë mënyra për bashkëpunim në sfera të ndryshme.</p>	<p>Republika e Maqedonisë së Veriut si pjesë e Evropës</p> <p>Nocionet: Vlerat evropiane Diversiteti kulturor</p>	<p>Analizë e dokumenteve për bashkëpunim të Republikës së Maqedonisë së Veriut me shtetet tjera evropiane në fusha të ndryshme.</p> <p>Debat mbi temën: Anëtarësia në BE-përparësi ose sfidë.</p> <p>Hulumtim dhe prezantim lidhur me diversitetin kulturor dhe vlerat e përbashkëta evropiane.</p> <p>Shfrytëzimi i TIK dhe vendosja e komunikimit me nxënësit, shkollat e Bashkimit Evropian dhe shkëmbimi i përvojave pozitive nga procesi arsimor në shtetet e tyre.</p>	<ul style="list-style-type: none"> – njohë përparësitë dhe sfidat nga anëtarësimi në BE, me këndvështrim të veçantë për interesat e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe qytetarëve të saj, – njohë vlerat e përbashkëta evropiane dhe t'i respektojë identitetin dhe diversitetin kulturor, – identifikojë shembuj të bashkëpunimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut me shtete tjera evropiane në fusha të ndryshme nga aspekti individual, familjar dhe aspektet tjera, – identifikojë mënyrat për shkëmbim dhe bashkëpunim të të rinjve të Maqedonisë së Veriut me të rinj nga shtetet tjera evropiane.

Vlerësimi i arritjeve të nxënësve	<p>Gjatë procesit arsimor arritjet e nxënësve ndiqen dhe vlerëson duke përdorur kritere të vlerësimit që, në fakt, në programin mësimor janë paraqitur si standarde për arritjen sa i përket çdo rezultati nga të mësuarit dhe përshkruajnë se çfarë pritet nga nxënësi të bëjë që të dëshmohet se është arritur rezultati nga të mësuarit. Gjatë procesit arsimor ndiqen aktivitetet e të mësuarit, motivimi për të mësuar, bashkëpunimi me të tjerët, raporti kritik nga ajo që është mësuar dhe raporti krijues i të mësuarit, respektivisht ndërtimi i qëndrimeve dhe pikëpamjeve të tyre për çështje të caktuara të materialit mësimor. Këto njohuri përdoren për të mbështetur nxënësit gjatë të mësuarit. Por, përdoren edhe strategji dhe teknika të ndryshme për vlerësimin formativ, duke përfshirë edhe vetëvlerësimin dhe vlerësimin e ndërsjellë.</p> <p>Baza e vlerësimit përmblendhës janë kriteret e vlerësimit të cilat duhet të specifikohen në nivel të shkollës apo në nivel të bashkësisë së shkollave/mësimdhënësve. Notat përmblendhëse caktohen në bazë të përdorimit të metodave dhe teknikave të ndryshme të vlerësimit që përputhen me kriteret e vlerësimit (pyetje ese, teste, prezantime me gojë, projekte ...). Në notën nuk ndikojnë qëndrimet e nxënësve për çështje të caktuara shoqërore, por vlerësohet aftësia për të analizuar, interpretuar dhe vlerësuar.</p> <p>Secili nxënës informohet rregullisht për arritjet e veta dhe, prindërit, gjithashtu, informohen për arritjet e nxënësit. Ky komponent është pjesë përbërëse e planifikimit të mësimdhënësit për mësimdhënien dhe të mësuarit.</p>
Literatura dhe burimet e tjera	Tekste shkollore dhe doracakë të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe burime të tjera të mësimin.
Fillimi i zbatimit të programit mësimor	Viti shkollor 2019/2020
Institucioni/ Bartësi i programit	Byroja për Zhvillimin e Arsimit (BZHA)

Потпис и датум на донесување на наставната програма	бр. 13-4390/17 11.6.2019 година <p style="text-align: right;">МИНИСТЕР, с.р. Dr. Arbër Ademi</p> <hr/>
Датум на ревизија	